If the territory of SAP Kosova is regarded in the point of view of basic relief sturcture, then of klimat, vegetation, soils and of the homogen development of historic and geographical trends, and if we follow the formaulation that „Principe of hegemonity understood predmoninently as sertain unique characteristics, as a hoolness of geographical phenomens that are inherent for any sheduled space", it can be said that the Kosova territory represents a unique real homogen region.

Bul. i pun. shkenc. i FSHN — Prishtinë
Zbornik radova PMF — Priština
IX, (1983—1986), (313 — 332)

KLIMA E ULQINIT

Nail Draga

Abstrakt

Ne këtë punim jemi perpjekur qe të japim veçoritë klimatike te Ulqinit dhe te rrethines se tij. Pasi ne hapesiren territorialë te komunes se Ulqinit gjindet vetem një stacion meteorologjik-Ulqini, te dhenat për këtë punim janë nga ai. Për te pasur me te qarta veçoritë klimatike te ketij rajoni, kemi përaqit ne mënyrë te veçanë të dhënat per çdo element klimatik. Pasi Ulqini si qender nodale-funksionale e komunes gjendet ne periferi te rajonit te tij komunal, te dhenat nga stacioni i tij meteorologjik nuk japin pasqyrë të saktë per gjendjen e elementeve klimatik sidomos per zonen e mbrendshme te rajonit. Kjo ne veçanti ka te bëjë per ditet me borë, mjegull, erë etj. Sidoqotë te dhenat qe po i japim në këtë punim deshmojnë per klimen e butë mesdhetare te ketij rajoni. Keto kushte jashtezakonisht te mira klimatike perveç ne aktivitetin turistik, ende nuk e kane gjetur aplikimin e tyre sidomos ne veprimtarinë bujqesore. Andaj ne këtë aspekt ka mbetur shumë per t'u punuar.

*
* *

Te dhënat e gjertanishme që janë dhënë ne lidhje mbi klimen e Ulqinit dhe te rrethines se tij janë jopraktike. Ne klimatologji jane praktike të dhënat e elementeve klimatik per periudhen mbi tridhjet vjeçare, ne te kunderten nuk paraqesin gjendjen faktike. Tek vrojtimet klimatike është e nevojshme qe te kemi te dhena per nje periudh sa më të gjatë vrojtuese, sepse ateher fitojmë pasqyren më të perafert per një vend te caktuar. Të dhënat e gjertanishme per Ulqinin jane per periudhen 25 vjeçare (1926—1940 dhe 1948—1957), ku gjer tani jane publikuar disa herë.[1]

[1] Për të parën herë të dhënat klimatike për Ulqinin i ka dhëne dr Pavle Mijović, *Podneblje Crne Gore*, Zbornik V kongresa geografa Jugoslavije, Cetinje 1959, f. 93—105, Pavle Mijović, *Ulcinj*, Beograd 1966, Jovan Đ. Marković, *Geografske oblasti SFRJ* Beograd 1972, *Crna Gora* (monografija), Književne novine, Beograd 1976 etj.

Ne ketu nuk do te marrim ne shqyrtim ato te dhëna, por do te analizojme te dhenat me të reja per periudhen 30 vjeçare (1949—1978). Kur flasim per klimen e një vendi apo rajoni para se gjithash duhet te dimë se çfare ndikimesh kanë faktoret klimatik, e pastaj elementet klimatik, sepse këta ne menyrë te drejtperdrejt janë te mvarur nga ata. Kjo mvarshmeri është e potencuar edhe me teper kur dihet se elementet klimatik jane labil, ndersa faktoret kli matik janë te pandryshueshem. Perveç faktoreve te pergjithshem qe ndikojne ne klimen e një hapësire poashtu edhe ne ate te rajonit te Ulqinit, rëndësi të veçant ka pozita gjeografike dhe veçorite e relefit.

Pasi rajoni i Ulqinit është i vendosur ne pjesen jugore te bregdetit te Adriatikut, është e qartë se kjo hapesirë është nen ndikimin e rrymave te ngrohta detare. Ndikimi i tyre rrymave detare është me i madh ne zonen e ngushtë bregdetare, ndersa ne mbrendesi te territorit te komunes vjen duke u zvogluar, sepse edhe relefi vjen duke ndryshuar. Pasi zona fushore e rajonit te Ulqinit është e çelur, pra nuk ka male te larta (bariera), keto rryma depertojne nepermes luginave dhe qafave malore pjesërisht edhe ne mbrëndësi, deri te zona malore e Anes së Malit (V—L). Ne pergjithesi rajoni i Ulqinit ka klimë mesdhetare (zona bregdetare deri te antiklinali Mozhur-Mali i Brisë (lumi Buna) dhe klimë te ndryshueshme mesdhetare (Ana e Malit).

Ne thellesi te zones malore të Anes se Malit gjindet Megjyreçi (oikonim) ne lartesinë mbidetare 722 m, ku është i vetmi vendbanim me klimë tipike malore. Ne këtë rast kushtet topografike kanë qënë ata te cilat ketij vendbnimi i kanë kushtëzuar një klimë të tillë. Duke i falenderuar lumit Buna ndikimi i klimes se butë mesdhetare deperton ne mbrendesi (pjesa lindore) deri te Liqeni i Shkodres.[2] Ne këtë rajon tani me nuk kemi klimë mesdhetare por klime te ndryshueshme mesdhetare. Rajoni i Ulqinit ka kushte jashtezakonisht te mira klimatike, ku ne te vertet bioklima e tij është njohur në tërë Evropen. Duke i falenderuar asaj ky rajon është bërë i njohur ne aspektin turistik, ndersa nese i shtojmë edhe plazhat e bukura me rërë te imet te cilat jane begati dhe raritete te rralla natyrore ateher është e qartë se pse disa bregdetin e Ulqinit e quajnë „banjë klimatike". Duke i falenderuar kushteve te mira klimatike ne këtë rajon ekzistojnë dy stinë te vitit; dimri i butë dhe me reshje nga tetori deri ne mars dhe vera e nxehtë dhe e thatë nga prilli deri ne shtator. Të dhënat per elementet klimatike qe po i japim këtu janë nga stacioni i vjeter meteorologjik ne Pinjesh (l. md. 97 m), i cili është shkaterruar nga termeti i 15. IV. 1979. Ne nderkohë është ndrequr objekti i ri pranë hotelit „Albatros". Stacioni meteorologjik i vendosur ne periferi te territorit komunal me teper ka karakter lokal se sa rajonal. Pasi zona e mbrendshme e ketij rajoni ka lartësi më të madhe mbidetare, morfologji tjeter te relefit, depertojnë me teper ernat veriore, bie me teper borë etj. është më së e domodoshme qe ne Anë të Malit te vendoset ndonjë stacion meteorologjik. Kjo është kerkesë e kohes sepse zona malore e ketij rajoni dallohet me shumë veçori nga zona fushore dhe ajo bregdetare. Ne këtë rast si vend me te pershtatshem per tu vendosur stacionet do te ishin psh. Shtegvasha, Kravari Naltë, Rashtisha

[2] Ne lidhje me këtë më gjërësisht lexo punimin tonë; *Lumi Buna-veçoritë hidrografike*, SHGJK, Kërkime gjeografike, nr: 6, Prishtinë 1985, f. 101—109.

Naltë apo Bojku, ndersa ne zonen fushore vend me i pershtatshem do te ishte Katërkolla. Per hulumtime te veçanta, më rëndësi do te ishte vendosja e një tjetri ne Megjyreç. Nese edhe me tutje ne Anë të Malit nuk do te këtë ndonjë stacion meteorologjik, ateher te dhënat nga stacioni meteorologjik i Ulqinit per këtë rajon janë vetem te përafërta. Eshtë e qartë se nga këto të dhëna, studimet e ndryshme klimatike te rajonit te Ulqinit, e ne veçanti per Anen e Malit janë vetem te pjesërishme.

TEMPERATURA

Nje nder elementet me të rëndësishem klimatik është edhe temperatura e ajrit, sepse gjendja e nxehtësisë dhe regjimi i temperatures se nje vendi percakton tipin klimatik. Eshtë më rëndësi te cekim se temperatura ndryshon me ndryshimin e gjërësisë gjeografike, nga ndryshimi i bilancit te ndriçimit, pastaj me ndryshimin e gjatesisë gjeografike, nga ndryshimi i ndikimit te rrymave detare dhe atyre kontinentale dhe lartesisë se relefit. Ne mvarshmeri me kushtet solare temperatura e ajrit ne vendin tonë kah gjëresitë më të larta zvoglohet ne të gjithë muajt, dhe ne mesataren e vleres vjetore. Nga ky faktor temperatura mesatare vjetore ne veri te vendit është me e ultë se sa e atyre vendeve te cilet kanë lartesi mbidetare te njëjt qe janë në jug te vendit per 1—2°C. Nga kjo del se temperatura e janarit shpejt zbret duke shkuar nga veriu se sa ajo e korrikut. Prandaj nga kjo arsy, ndryshimi vjetor i temperatures rritet ne te njejtin drejtim.[3]

Ndryshimi i temperatures me gjatesinë gjeografike është i lidhur me ndryshimet e nxehtesisë specifike te siperfaqes se Tokës dhe mundesinë e bartjes se masave ajrore nga drejtimet e ndryshme. Nga keto faktor temperatura e ajrit ndryshon nga deti ne drejtim te mbrendesisë se vendit. Ky ndryshim është i tillë ku temperatura normalisht dimrit menjeher zbret nga bregdeti drejt mbrendesisë se sa qe veres rritet. Nga kjo del se zona bregdetare është si vend ku fillon ndryshimi i temperaturave, ne veçanti duke shkuar kah mbëndësia e territorit. Një gjë të ngjajshme kemi edhe me rajonin e Ulqinit.

Ne rajonet bregdetare zbritja e temperatures duke shkuar kah lartësitë më të medha, ne ato vise dimrit rritet nga nxemja e shtreses prane bregore te ajrit nga deti, ndersa veres është diçka me i lartë së sa ne viset kontinentale. Nga një rezultat i tillë ndryshimet vjetore te temperatures se ajrit rriten deri të një lartësi e caktuar, ndersa pastaj zbresin.[3]

Ulqini dhe rrethina e tij bënë pjesë ne regjionin bregdetar, me temperaturen mesatare vjetore 15,6°C, që është nder vendet me te ngrohta ne vend. Temperaturat mesatare maksimale Ulqini i ka ne korrik (24,4° C), ndersa ato minimale ne janar (7°C). Amplituda mesatare vjetore është 16,8°C (tabela nr: 1).

---

[3] Dr Đuro Radinović, *Vreme i klima Jugoslavije*, Građevinska knjiga, Beograd 1981, f. 291.

Tabela nr. 1. Temperatura mesatare mujore dhe apsolute per Ulqinin (1949–1978)

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Mesatare	7,0	8,5	10,1	13,8	18,0	21,8	24,4	24,3	21,0	16,8	12,5	9,0	15,6
Mes. maks.	10,4	10,7	12,6	16,3	20,7	23,5	27,2	26,7	23,0	19,3	15,5	11,2	16,8
Mes. mini.	4,1	3,0	7,4	11,7	16,0	20,1	22,6	20,9	18,3	13,0	10,7	6,3	14,7
Aps. maks.	18,2	20,6	25,4	26,8	32,7	34,9	38,5	38,1	34,0	29,3	24,1	18,1	38,5
Aps. mini.	−8,4	−8,3	−5,0	3,0	5,2	10,0	12,3	12,8	8,6	1,1	−2,0	−5,6	−8,4

Nga tabela shihet se temperaturat më të larta te ajrit ne këtë rajon janë gjatë stines se veres ku temperatura mesatare mujore është 23,5°C. Pastaj vjene stina e vjeshtes (16,7°C), pranvera (13,9°C) dhe dimri (8,1°C). Edhe pse dimri është stina më e ftohet e vitit temperatura mesatare mujore nuk është nen 8°C, ku shumë vise dhe vende kane temperaturat mesatare vjetore) Andaj dimri i butë dhe me reshje, ndersa vera e thatë dhe e gjatë janë veçoritë kryesore klimatike te Ulqinit dhe rrethines se tij. Në këtë rajon praqiten shumë pak ditë më ngrica gjithsej 9,7 ne vite ($T \leq 0$ C). Ngricat me se tepermi paraqiten gjatë stines se dimrit (4 ditë ne janar, 3 ditë ne shkurt) ndersa shumë rrallë ne vjeshtë apo pranverë. Nga ana tjeter numri i diteve tropike ($T \geq 30$°C), gjatë vitit janë 31,4 kuptohet gjate stines se veres. Me se tepermi ditë tropike ka ne gusht 12,5, ne korrik 12,2 dhe ne shtator 3,1 qe tregojnë kushte jashtezakonisht te mira per aktivitetet e ndryshme jetësore. Pjesa tjeter e diteve tropik (2,6) janë ne muajt tjere çka do te thot se rrallë gjendet ndonje vend tjeter si Ulqini dhe rajoni i tij ne vend me shperndarje optimale te tyre. Temperatura mesatare ditore e ajrit (per periudhen 1964–1978) e matur ne 7^h është 13,7°C (vlera vjetore), ndersa per janar 5,5°C, korrik 22,6°C. Ndersa temperatura mesatare ditore e ajrit e matur ne ora 13h është 18,5°C, ne janar 9,7°C e ne gusht 28,2°C, dhe në ora 21^h temperatura mesatare ditore e ajrit është 15,6 C,°ne janar 6,7°C dhe gusht 23,0°C. Temperatura apsolute maksimale është 38,5°C (korrik) ndersa temperatura apsolute minimale është −8,4°C (janar), ndersa amplituda vjetore eshte 46,9°C. Ndryshimi ne mes maksimumit dhe minimumit mesatar veror ne rajonin e Ulqinit është 7,1°C, ndersa ne mes ekstremeve apsolute është 28,5°C. (tabela nr: 2). Keto ndryshime te temperatures tregojnë së gjatë veres mund te paraqiten edhe temperatura te ulta (minimumi apsolut 10°C ne qershor, 12,3°C ne korrik dhe 26,7°C ne gusht tregon se numri i diteve tropike ne gusht janë 30 ndersa ne korrrik 23 dhe ne shtator 12 dite. Ditet tropike ne kete rajon paraqiten edhe ne qershor (11 dite), maj (2) dhe ne prill (1). Nga ana tjeter me temperatur mesatare apsolute minimale ne muajt e veres numri i diteve tropike është shumë i vogel e ato vetem tre ditë ne korrik. Ditet me temperatur te larte janë te demshem per organizem dhe vegjetacion me ç'rast paraqiten thatësirat.

Tabela nr. 2. Temperatura mesatare dhe apsolute verore ne Ulqini (1949–1978)

	VI	VII	VIII	Mes. verore
Mesatare mujore	21,8	24,4	24,3	23,5
Mesatare maksimale	23,5	27,2	26,7	25,8
Mesatare minimale	20,1	22,6	20,9	21,2
Maksimale apsolute	34,9	38,5	38,1	37,1
Minimale apsolute	10,0	12,3	12,8	11,7

Qe te kemi një pasqyrë sa më të qartë te raporteve te temperaturave ne rajonin e Ulqinit po japim te njëjtat elemente edhe per stinet tjera (dimrin, pranveren dhe vjeshten).

Maksimumi mesatar gjatë stines se dimrit është 11,2 °C (janar), ndersa minimumi mesatar është 3 °C (shkurt), ndersa ndryshimi ne mes tyre është 14,2 °C. Temperatura apsolute maksimale eshte 20,6 °C (shkurt), ndersa ajo apsolute minimale −8,4 °C (janar) me ndryshim shumë të lartë 29 °C. Numri i diteve me ngrica është 9,7, ndersa maksimumi mesatar i tyre është 52 ditë. Nga to 17 ditë janë në janar dhe ne shkurt, 9 ne mars 6 ne dhjetor dhe 3 ne nëntor. Temperaturat e ulta dhe ngricat gjatë stines se dimrit janë si pasojë e depertimit te masave te ftohta te ajrit në këtë rajon nga veriu dhe veri-lindja (tabela nr: 3).

Tabela nr. 3. Temperatura mesatare dhe apsolute dimërore ne Ulqin (1949–1978)

	XII	I	II	Mes. dimrore
Mesatare mujore	9,0	7,0	8,5	8,1
Mesatare maksimale	11,2	10,4	10,7	10,7
Mesatare minimale	6,3	4,1	3,0	4,4
Maksimale apsolute	18,1	18,2	20,6	18,9
Minimale apsolute	−5,6	−8,4	−8,3	−7,4

Maksimumi mesatar ne pranverë nga 12,6 °C ne mars vjenë duke u rritur deri ne 20,7 °C ne maj, ndersa mesatarja është 16,5 °C. Ndryshimi ne mes maksimumit dhe minimumit mesatar eshte 13,3 °C. Temperaturat mesatare apsolute minimale ne pranverë janë shumë të larta 11,7 °C. Ata nga 7,4 °C ne mars vijnë duke u rritur deri 16 °C ne maj. Temperaturat apsolute maksimale ne pravcerë më të larta janë në maj (32,7 °C) ndersa me te ulta ne mars (25,4 °C), më një mesatare shumë të lartë 28,3 °C. Nga

ana tjeter minimumi apsolut, temperaturat më të ulta i ka në mars (−5,0 °C), e ato me te lartat ne maj (5,2 °C), më një mesatare shume te ulet prej 1,06 °C. (tabela nr: 4). Ngricat ne pranverë janë dukuri shumë e rrallë. Edhe nese paraqiten ata, ateher ai muaj është marsi (1,2 ditë). Nga ana tjeter maksimumi i ngricave ne pranvere është 9 ditë, por zgjasin shumë pak dhe kanë ndikim shumë të vogel ne kulturat bujqësore.

Tabela nr. 4. Temperatura mesatare dhe apsolute pranverore ne Ulqin (1949−1978)

	III	IV	V	Mes. pranverore
Mesatare mujore	10,1	13,8	18,0	13,9
Mesatare maksimale	12,6	16,3	20,7	16,5
Mesatare minimale	7,4	11,7	16,0	11,7
Maksimale apsolute	25,4	26,8	32,7	28,3
Minimale apsolute	−5,0	3,0	5,2	1,06

Temperaturat e larta ne pranverë pozitivisht ndikojnë ne veprimtatitë bujqësore dhe ne organizmin e njeriut. Temperaturat mesatare maksimale kan ndikim te kundert ne bujqesi nga ato mesatare minimale, prandaj janë shumë të rëndësishme nga aspekti bujqësor.

Temperatura mesatare minimale ne muajt e vjeshtes jane 14 °C. Ato nga shtatori (18,3 °C) vijnë duke u zvogluar dhe në nëntor janë me te ulta (10,7 °C). Nga ana tjeter temperaturat apsolute minimale me te ulta janë në nëntor (−2,0 °C), ndersa me te larta ne shtator (8,6 °C) me një mesatare 2,56 °C (tabela nr: 5). Nga ana tjeter temperaturat apsolute maksimale nga shtatori (34 °C) zvoglohen duke shkuar kah nëntori (24,1 °C) çka është edhe dukuri normale. Numri i diteve me ngrica ne vjeshte është shumë i vogël (0,3), bile me i vogël se ne pranverë çka është si rezultat i ndikimit termik te Detit Adriatik. Vlera mesatare maksimale e diteve me ngrica është tre dite dhe ate ne nëntor.

Tabela nr. 5. Temperatura mesatare dhe apsolute gjate vjeshtes ne Ulqin (1949−1978)

	IX	X	XI	Mes. vjeshtore
Mesatare mujore	21,0	16,8	12,5	16,7
Mesatare maksimale	23,0	19,3	15,5	19,2
Mesatare minimale	18,3	13,0	10,7	14,0
Maksimale apsolute	34,0	29,3	24,1	29,1
Minimale apsolute	8,6	1,1	−2,0	2,5

Per ta pasur të qartë ndryshimin e temperaturave ne rajonin e Ulqinit po i japim ato sipas stineve (tabela nr: 6). Stina më e nxehtë është vera ku temperatura mesatare është 23,5 °C, ndersa më e ftohtë është dimri 8,1 °C. Vjeshta me 16,7 °C është me e nxehtë se pranvera me 13,9 °C per 2,8 °C, ku shihet ndikimi i regjimit maritim ne elementet klimatike.

Tabela nr. 6. Temperaturat mesatare mujore dhe vjetore sipas stineve te vitit per ulqinin dhe rajonin e tij (1949–1978)

Dimri				Pranvera				
	Muajt		Mesatare		Muajt			Mesatare
XII	I	II		III	IV	V		
9,0	7,0	8,5	8,1	10,1	13,8	18,0		13,9
Vera				Vjeshta				
	Muajt		Mesatare		Muajt	Mesatare	Mes. vjetore	
VI	VII	VIII		IX	X	XI		
21,8	24,4	24,3	23,5	21,0	16,8	12,5	16,7	15,6

Sipas të dhënave te lartëshenuara te temperaturave mesatare mujore sipas stineve te vitit mund te themi se rajoni i Ulqinit ka klime të butë mesdhetare ku dominon vera e nxehtë dhe e thatë dhe dimri i butë me reshje. Keto temperatura te larta perveç ne veprimtarin turistike (gjatë veres) ende nuk janë shfrytezuar per prodhimet e kulturave te ndryshme bujqësore. Shikuar ne pergjithësi ky rajon ka temperatura te larta duke i falenderuar se pari pozites gjeografike, gjegjesisht ndikimit te Detit Adriatik sepse „ndikimi termik i çdo deti mepadyshim me i madh është dimrit se sa verës.[4]

RESHJET

Pas temperaturave te larta vjetore, reshjet janë elementi klimatik qe me se tepermi e veçon rajonin e Ulqinit. Nga sasia dhe shperndarja e tyre gjate tërë vitit mvaren shumë veprimtari njërzore. Ne tërësi ky rajon te reshura ka mjaftë, por shperndarja vjetore e tyre nuk është e rregullt· Një gjë të tillë mepadyshim e kushtëzon nderlikueshmeria e relefit. Edhe pse relefi është vetem modifikator i hapesirës, rëndësia e tij per shperndarjen e reshjeve është shumë e madhe. Shperndarja gjeografike e reshjeve është si pasojë e shkaqeve komplekse.[5] Së është relefi modifikator me rëndësi

[4] Tomislav Šegota, Klimatologija za geografe, Školska knjiga, Zagreb, 1976 f. 412.

[5] *Po aty* f. 460.

shihet edhe ne diferencimin hapesinor te reshjeve edhe ne rajonin e Ulqinit. Me se t'permi reshje biejne ne pjesen veriore (zona malore) ndersa më pakë ne zonen fushore dhe bregdetare, (shih harten nr: 1).

Rajoni i Ulqinit i perket regjimit pluviometrik mediteran (maritim) te reshjeve, i cili veçohet me sasinë maksimale te reshjeve ne pjesen e dytë të vjeshtes, ndersa ato minimale gjatë stines se verës. Sasia vjetore e reshjeve ne Ulqin është 1321 mm. Nga Ulqini duke shkuar ne veri te bregdetit te Adriatikut sasia e reshjeve vjenë duke u rritur dukshem, ku ne Bokë te Kotorrit ne vendin e quajtur Krivoshje ajo sasi arrin mbi 5000 mm. Njeherit ky është vendi me reshje më të medha jo vetem ne Jugosllavi por edhe në Evropë.

Pas sasisë se reshjeve regjimi i tyre është veçoria me e rëndësishme e ketij elementi klimatik. Me regjimin e reshjeve kuptohet shperndarja kohore e tyre gjate tërë vitit. Një nder menyrat qe te tregohet regjimi i reshjeve është ndryshimi relativ vjetor i tyre. Kjo llogaritet nga formula $r\frac{Rx-Rn}{R}$ 100; ku Rx është sasia me e madhe mesatare mujore e reshjeve, Rn me e vogla, ndersa R është sasia e pergjithshme vjetore e reshjeve në një vend të caktuar.[6] Ndryshimi i fituar paraqitet ne perqindje. Nga llogaritjet qe kemi bërë, ndryshimi vjetor i reshjeve per rajonin e Ulqinit është 11,6%, ku deshmohet se ndryshimi i tillë vjetor, është si rezultat i ndikimit te regjimit maritim. Tek vendet qe kane regjim kontinental te reshjeve ndryshimi vjetor i reshjeve (ne %) është më i vogel. Andaj edhe nga kjo mënyrë shumë lehtë percaktohet regjimi i reshjeve ne nje vend te caktuar. Sasia e reshjeve ne rajonin e Ulqinit nga njeri muaj ne tjetrin ndryshon shumë, andaj ato edhe nuk kanë shperndarje te rregullt (tabela nr: 7).

Tabela nr. 7. Sasia mesatare mujore dhe vjetore e reshjeve ne Ulqin (1949–1978)

I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
163	140	121	108	72	56	28	42	108	140	181	162	1321
12,3	10,5	9,2	8,2	5,5	4,2	2,1	3,1	8,1	10,5	13,7	12,2	100,0%

Sasia maksimale e reshjeve është në nëntor (181 mm) dhe ne janar (163 mm) e dhjetor (162 mm). Reshje me pak biejne gjatë veres ku ne mënyrë negativë ndikojne ne boten bimorë dhe ne kulturat bujqësore Muaji me sasi me te vogel te reshjeve eshte korriku me 42 mm apo 2,1%. Ne ciklin vjetor te reshjeve qartë shihet së është i theksuar maksimum vjetor gjatë vjeshtes dhe dimrit. Ne keto dy stinë te vitit biejnë 894 mm reshje apo 69,7% (tabela nr: 8). Gjatë stines se veres biejnë më pak reshje gjithsej 126 mm apo 9,5% te tyre. Ne këtë stinë organizmit te njeriut dhe bimesisë i janë të nevojshme reshjet por mu ne at kohë ata i mungojne. Pasi shperndarja e reshjeve është jo e rregullt krijohen dy stinë me veçori te kundërta; vera e nxehtë dhe e thatë dhe dimri i butë dhe më të reshura.

[6] Dr Đuro Radinović, v. c. f. 313.

Tabela nr. 8. Shperndarja vjetroe e reshjeve sipas stineve ne Ulqin (1949–1978)

Sasia e reshjeve	Pranvera	Vera	Vjeshta	Dimri	Vjetore
ne mm	301	126	429	465	1321
ne %	22,7	9,5	32,4	35,2	100,0

Sasia mujore dhe vjetore e reshjeve nuk mundet në tërësi te percaktojë karakterin klimatik te ketij elementi. Per zhvillimin e vegjetacionit dhe te shumë çeshtjeve te tjera praktike është e nevojshme qe te dihet sasia mujore dhe vjetore e reshjeve, gjegjesisht numri i diteve me reshje dhe intenziteti i tyre. Njohja e levizjes se numrit te diteve me reshje gjatë vitit ka rëndësi të madhe sepse, nga këto të dhëna më lehtë mund te percaktojmë aktivitetin jetësor. Me se tepermi ditë me reshje ka në ato muaj qe kanë më së tepermi reshje dhe e kunderta. Me teper reshje biejnë ne pjesen veriore te rajonit apo me mirë te themi ne zonen malore (shih harten nr: 1).

Sa i perket numrit te diteve me reshje po japim të dhënat per dy periudha te ndryshme kohore; e para 1966–1975 per 1 mm dhe e dyta 1931–1980 per lomm (tabela nr: 9). Gjatë tërë vitit deri ne 1 mm reshje kemi 96 ditë. Me teper biejne ne dimër (32 ditë), vjeshtë (24 ditë) ne pranverë (26 ditë) ndersa me pakë ne verë (13 ditë). Nga ana tjeter dite më reshje deri ne lomm në vitë per këtë rajon janë 42,5, pra me pak se ato te parat çka është edhe e arsyeshme, që më teper biejnë zakonisht gjate stinës së dimrit (15,6 ditë). Me pak reshje me intenzitet te tillë ka gjatë veres (4,2 ditë).

Tabela nr. 9. Numri mesatar i diteve me reshje sipas muajve gjatë vitit në Ulqin

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
1 mm	12	10	9	12	5	6	4	3	6	9	9	10	96
10 mm	5,4	4,6	4,4	4,0	2,3	1,8	1,0	1,4	2,0	4,0	5,1	5,6	42,5

Per bimet dhe kulturat bujqësore më rëndësi shumë të madhe është numri diteve me reshje prej lomm sidomos gjatë periudhes vegjetative. Ne periudhen vegjetative kur bimet bulojnë dhe zhvillohen gjithsejt biejnë 414 mm reshje apo 31,3% te tyre (tabela nr: 10), ndersa në këtë periudh temperatura mesatare është shume e lartë (20,5 °C), ndersa jashtë kesaj ajo është më e vogël (10,6 °C). Në këtë periudh sasia e reshjeve është me e madhe 907 mm apo 68,6% të tyre.

Tabela nr. 9. Vlerat mesatare të reshjeve dhe temperaturave në periudhen vegjetative dhe jashtë saj në Ulqin (1949–1978)

Periudha vegjetative			Periudha jashtëvegjitative			Vjetore	
IV–IX			X–III–				
në mm	%	Tem. mes.	në mm	%	Tem. mes.	mm	%
414	31,3	20,5	907	68,6	10,6	1321	100,0

Nga këto të dhëna del se periudha vegjetative nuk ka te reshura te mjaftueshme, andaj shpeshherë ne rajonin e Ulqinit gjatë veres paraqiten edhe thatësirat qe negativisht ndikojnë në bujqësi. Perveç numrit te diteve me reshje rëndësi te madhe ka edhe levizja vjetore e tyre sidomos nga aspekti praktik. Maksimumi i reshjeve ne ato vende, ku dominon regjimi maritim



Harta nr: 1. Shperndarja hapësinore e reshjeve në rajonin e Ulqinit

i tyre është gjate natës (pas mesnates) ndersa ne vendet tjera me regjim kontinental është e kunderta.

Per nevojat e ndryshme ekonomike sidomos ne mjediset urbane rëndësi të madhe ka ëdhë intenziteti i reshjeve. Ali llogaritet më anë te pluviografit qe regjistrojnë sasinë e reshjeve. Intenziteti i reshjeve matet ne njesinë kohore (1-minutshe, 5-minutshe, 10-minutshe, 1-oreshe etj.), por të rrallë janë ato stacione shimatese qe janë të paisura me pluviograf, prandaj njësi kohore e reshjeve merret „njëditeshi".[7] Intenziteti i reshjeve shkon krahas shperndarjes se tyre gjatë tërë vitit. Keshtu per rajonin e Ulqinit intenziteti me i madh i reshjeve është gjatë dimrit dhe vjeshtes, ndersa me i vogël gjatë veres. Më një fjalë kur janë temperaturat më të ulta reshje ka më shumë ndersa kur temperaturat janë më të larta reshje ka më pak (shih grafikonin nr: 1).



Grafikoni nr: 1. Paraqitja grafike e reshjeve dhe e temperaturave (mesarare) per stacionin e Ulqinit (1949–1978)

[7] *Po aty*, f. 319.

BORA

Kur shikohet ne dimenzionet globale del se sasia me e madhe e reshjeve ne rruzullin toksore i perket shiut. Sipas rëndësisë qe ka reshje e dyte është bora. Te reshurat e borës zakonisht paraqiten gjatë stines se dimrit. Numri i diteve me borë rritet nga vendet e ulta kah ato më të larta. Me se paku ditë me borë ka brezi i ngusht i bregdetar. Me rritjen e lartësisë mbidetare pjesmarrja e bores ne sasinë e pergjithshme te reshjeve vjen duke u rritur e gjithashtu edhe numri diteve më borë. Perveç lartesisë mbidetare dhe gjerësisë gjeografike qendrimi i bores mvaret edhe prej kushteve topografike, ekspozimit te terrenit, ndikimit te regjimit maritim dhe kontinental etj. Pasi Ulqini është vendi me jugor ne bregdetin e Adriatikut, ketu numri i diteve me borë është shumë i vogël, gjithsej 1,72 ditë ne vit. Bora në këtë rajon edhe pse paraqitet rrallë ajo bjenë gjatë stines se dimrit e rrallë herë ne fund te vjeshtes (tabela nr: 10). Ne Ulqin, bora është si dukuri e rrallë dhe kur bjenë qendron shumë pak. Ndersa ne rrethinen e tij situata ndryshon shumë sepse ne pjesen veriore te territorit te komunes (Ana e Malit) bora gjatë vitit qendron nga 10—15 ditë ne vit. Pasi në këtë zonë nuk ekziston asnjë stacion meteorologjik nuk disponojmë të dhëna të tilla.

Tabela nr. 10. Numri i diteve me borë sipas muajve në Ulqin (1961—1980)

Muaji	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Nr. diteve	0,7	0,7	0,2	—	—	—	—	—	—	—	0,2	0,1	1,72

Sikurse bora që është dukuri e rrallë ne këtë rajon një gjë e tillë ndodh edhe me ngricat. Ato ketu paraqiten ne gjysmen e dytë te vjeshtes (në nëntor 0,3 ditë) dhe zgjasin deri ne fund te dimrit (ne mars 1,2 ditë). Ne Ulqin mesatirisht janë gjatë vitit 9,7 ditë me ngrica (tabela nr: 11). Me se tepermi ditë me ngrica ka në janar (4), shkurt (3), ndersa me pak ne mars dhe ne dhjetor.

Tabela nr. 11. Numri i diteve me ngrica sipas muajve ne Ulqin (1949—1978)

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Mesatare	4,0	3,0	1,2	—	—	—	—	—	—	—	0,3	1,2	9,7
Maksimale	17	17	9	—	—	—	—	—	—	—	3	6	52
Minimale	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—	—

Numri mesatar maksimal i diteve me ngrica gjatë vitit ne Ulqin është 52 ditë. Me se tepermi ditë paraqiten ne janar dhe ne shkurt (17), ndersa me pak ne mars (9), dhjetor (6) dhe ne nëntor (3 ditë). Nga këto të dhëna del se Ulqini dhe rajoni i tij ka shumë pak ditë me ngrica, dhe se ato paraqiten ne fund te vjeshtës, gjatë dimrit dhe ne fillim te pranverës.

RREZATIMI DIELLOR

Rrezatimi diellor si element klimatik ka rëndësi te madhe per këtë rajon sepse ai ketu zgjaten shumë, duke i falenderuar vranesisë se pakët edhe pse gjatë vitit këtu biejnë shumë reshje. Rrezatimi diellor ka rëndësi te madhe sepse ndikon pozitivisht ne lloj-llojshmerinë e bimesisë. Ne menyrë stimulative ndikon edhe te njeriu dhe te aktiviteti i pergjithshem i tij.[8] Vranësia nuk është faktori i vetem qe mvaret gjatesia e rrezatimit diellor, sepse ai mvaret edhe nga konfiguracioni i terrenit dhe stinet e vitit. Zgjatja e rrezatimit shprehet me numrin e oreve te ndriçimit te Diellit gjatë vitit apo me mesataren e oreve në ditë.[9] Nga kushtet astronomike është percaktuar se rrezatimi diellor është më i gjatë ne stinet e nxehta se sa ne ato te ftohta. Zgjatja e ndriçimit te Diellit apo rrezatimit te tij është element i rëndësishem klimatik, sidomos per zhvillimin e turizmit dhe te prodhimtarisë bujqësore. Më së tepermi rrezatim ne bregdetin e Malit te Zi ka Ulqini (2563 orë ne vit) ndersa pas tij vjenë Tivari etj. Mesatarisht ne Ulqin ka çdo ditë 7,02 orë me diell. Me se tepermi ka korriku (11,4) dhe gushti (10,5), ndersa me pak dhjetori (3,6), janari (4) dhe shkurti (4,2). Sasia e rrezatimit diellor vjenë duke u rritur prej marsit deri ne korrik nders pastaj gradualisht zvoglohet (tabela nr: 12). Sa i perket shperndarjes se rrezatimit sipas stineve me se tepermi ka ne verë (38,3%), pastaj në pranverë (25,2%), vjeshtë (22,4%) dhe dimer (13,9%).

Tabela nr. 12. Rrezatimi mujor dhe vjetor sipas oreve ne ulqin (1949–1978)

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Mesatare	124	120	172	202	272	303	354	327	249	201	126	113	2563
Maksimale	198	238	263	269	326	354	403	372	296	269	215	173	2717
Minimale	65	57	93	143	214	242	288	277	205	103	71	73	2372

Sipas muajve në përqindje pjesmarrje më të madhe kanë korriku (13,8%), gushti (12,7%), qershori (11,8%) ndersa me pak dhjetori (4,4%), shkurti (4,6%, janari (4,8%) dhe nëntori (4,9%).

Me siguri mund te konstatojmë se te paket janë ato regjione ne Mesdhe me perjashtim te pjeses veriore te Egjiptit dhe disa rajoneve te Spanjes qe kanë rrezatim me teper se sa pjesa jugore e bregdetit te Malit të Zi.[10] Si rezultat i temperaturave te larta verore dhe intenzitetit te lartë të ndriçimit te diellit bregdeti i Ulqinit është një nder zonat me teheqese turistike ne bregdetin e Adriatikut.

---

[8] Grup autoresh: *Potencijali priuspona priobalnog područja Crne Gore*, IDEI, Titograd, 1970, f. 16.

[9] Dr Duro Radinović, *v.c.* f. 309.

[10] Grup autoresh, *Potencijali* . . . f. 17.

VRANËSIA

Madhesia e kupes se qiellit, e cila është e mbuluar me re, quhet vranësi. Ne te vertet kjo është një element meteorologijik qe percaktohet në mënyrë vizuele me shikim të lirë. Vlersohet me shikim se cila pjesë e qiellit është e mbuluar me re dhe kjo shprehet në të dhjeta te tërë qiellit qe shihet me sy. Kjo do te thot se i tërë qielli ndahet ne lo pjesë të njëjta, dhe pastaj vlersohet se sa pjesë të tilla jane te mbuluara më re. Kur qielli është i mbuluar me re thuhet se vranesia është 10. Kur nuk ka re fare, dmth. kur moti është plotesisht i kthjellet, vranësia shenohet me 0, e nese gjysma është e mbuluar me re ateher shenohet se vranësia është 5 etj.[11]

Vranësia ka rëndësi te madhe sepse ajo ndikon ne mënyrë te drejteperdrejtë ne rrezatimin diellor, ne temperatur dhe nepermes te saj ne te gjithë elementet tjerë klimatik. Sa më teper që të këtë vranësi ne pjesen e ftohët te vitit ajo e mbron token nga ftohja e saj, ndersa veres ndodh e kundërta. Vranësia para se gjithash është e lidhur në menyrë gjenetike me ciklonet e me pak me paraqitjet lokale te motit te lig.[12] Vrojtimet shumëvjeçare tregojnë se kjo anë ka shumë vranësi. Keshtu gjate vitit në këtë rajon ka gjithsej 88 ditë. Ajo me se tepermi paraqitet kah fundi i vjeshtes (nëntor 12 ditë) dhe gjatë dimrit (per çdo muaj te stines nga 12 ditë), ndersa me pak ka në pranvere dhe verë. Pjesmarrja e vranësisë sipas stineve është me e madhe ne dimër 40,9%, pranverë 28,4%, vjeshtë 26,1% dhe ne verë 5,6%. (tabela nr: 13). Nga këto të dhena del se gjatë verës vranësia është shumë e vogël, sidomos ne korrik dhe gusht, andaj ne këtë kohë temperaturat janë më të larta, ku një gjë ndodh edhe me rrezatimin diellor, ku vera merr veçorit e veta si stinë e nxehtë dhe e thatë me temperatura të larta.

Sa i perket levizjes ditore të vranësisë ne vendet bregdetare ajo maksimumin e vetë e ka ne mengjes, ndersa minimumi i saj paraqitet ne mbremje apo gjatë nates.

Tabela nr. 13. Numri mesatar i diteve të kthielita dhe me vranësi në Ulqin (1949–1978)

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjetore
Kthiellësi	7	6	7	6	9	11	19	19	14	11	5	6	119
Vranesi	12	12	10	9	6	12	1	1	4	7	12	12	88

Nga të dhënat e lartëshenuara del se aty ku me se tepermi ka ditë më vranësi ka me pak ditë të kthiellta dhe anasjelltas. Kuptohet me se tepermi ditë të kthiellta ka gjatë veres (39), pastaj gjatë vjeshtes (30), ndersa me pak ne pranverë (22) dhe ne dimër (19). Shikuar ne pergjithesi veres janë 32,7% ditë te kthiellta, pastaj ne vjeshtë 25,2%, pranverë 18,4% dhe ne dimër

[11] Dr Marko Milosavleviq, *Meteorologjia*, ETMM i KSAK, Prishtinë, 1983. f. 139.

[12] Dr Tomislav Šegota, *v. c.* f. 459

më së paku 15,9%. Zvoglimi i numrit te diteve te kthiellta nga vera kah vjeshta e dimri është ne lidhje me rritjen mesatare mujore te lagështisë së ajrit, vranësirave dhe reshjeve.

Rajoni i Ulqinit nuk është i pasur me mjegull. Edhe pse paraqitet rrallë ajo është e pranishme me se tepermi ne muajt e vjeshtes dhe te pranveres pranë lumit të Bunës, liqenit te Zogajve dhe ati te Shasit si edhe ne Anë te Malit. Gjatë veres ajo paraqitet me se tepermi ne mengjes. Pasi stacioni meteorologjik ne Ulqin nuk bënë matjen e mjegulles ne nuk jemi në gjendje te japim saktësisht të dhënat ne lidhje me te. Llogaritet se numri mesatar i vjetar i diteve me mjegull ne Ulqin është i vogël (11).[13] Pas bores edhe mjegullat jane dukuri e rrallë per rajonin e Ulqinit.

LAGËSHTIA E AJRIT

Lagështia e ajrit është njera nder veçoritë me të rëndësishme te motit dhe të klimës. Ajo percakton sasinë e reshjeve, zvoglon kthiellteSinë, mban ndriçimin diellor etj. Paralelisht me te, lagshtia e ajrit paraqet ndikim te madh ne njeriun, boten bimore dhe shtazore.[14] Lagështinë ajri e fiton nga avullimi i ujit, tokes së laget dhe mbuleses bimore. Ky proces i avullimit është i perhershem prandaj edhe lagështia është e perhershme ne ajër. Temperatura është faktor kryesor qe te zhvillohet tërësisht ky proces, andaj me ndryshimin e temperatures ndryshon edhe lagështia e ajrit. Kjo mvarshmeri është ne menyrë reciproke. Per te percaktuar sasinë e lagështisë së ajrit shfrytezohen madhësi te ndryshme; lagështia specifike, lagështia apsolute etj. Nga aspekti biologjik rëndësi me të madhe ka lagështia relative. Lagështia relative paraqet shkallen e sasisë se avullit së ujit ne ajër. Kjo do te thot se perqindja është me e madhe kur ajri është me i dendur me avull uji dhe anasjelltas. Nga ana tjeter kjo madhësi mvaret shumë nga temperatura, keshtu më zvoglimin e temperatures lagështia relative rritet, ndersa me rritjen e temperatures ajo zvoglohet. Nga raporti invers me temperaturen është normale qe lagështia relative te jetë më e madhe ne muajin më të ftohet, ndersa me e vogël ne muajin me të nxehtë te vitit.[15]

Lagështia relative e ajrit ne te vertet paraqet shkallen e ngimjes së ajrit me avull uji. Nese lagështia relative e ajrit është 0%, kjo do te thot se ajri është i ngim me avull uji. Prandaj nese lagështia relative është 75% kjo do të thot se ajri ne vete ka pranuar tri te tretat e asaj sasie te avullit te ujit, te cilen temperatura perkatese është në gjëndje te pranojë ne vete dhe te jetë i ngimë.[16]

Ne tërë bregdetin vlerat vjetore te lagështisë relative te ajrit janë më të vogla së sa ne pjesen kontinentale te vendit. Lagështia relative është më e madhe kur fryejne erërat nga kuadranti jugor, ndersa me rastin e deperti-

---

[13] Dr Đuro Radinović, *v. c.* f. 330

[14] Radmilo Milosavljević, *Prikaz analiza pritisaka vodene pare (apsolutne vlažnosti) iznad Bosne i Hercegovine*, Geografski pregled, GDBiH, Scrajevo, 1970, f. 3.

[15] Dr Đuro Radinović, *v. c.* f. 300–301.

[16] Dr Marko Milosavleviq, *v. c.* f. 114.

mit te masave te ajrit të ftohet dhe te thatë nga kuadranti i veriut ajo zvoglohet.[17] Sa i perket ndryshimit te lagështisë së ajrit sipas lartesisë mbidetare nuk ekziston ndonjë rregull unike. Keshtu veres gjatë ngritjes ajri adiabatikisht ftohet kurse lagështia relative arrin vleren 100%. Prej kesaj lageshtie e metej lageshtia relative rendom ngel 100% deri te maja e maleve. Nese ajri leshohet prej se larti kah toka ai adiabatikisht ngrohet dhe lagështia relative e ajrit zvoglohet. Nga ana tjeter dimrit rendom lagështia relative e ajrit zvoglohet me rritjen e lartësisë mbidetare, gjë që është ne lidhje me shtresat inverzive te temperatures ne rajonet malore.[18]

Sipas të dhënave per periudhen vrojtuese 30 vjeçare vlera mesatare vjetore e lagështisë relative te ajrit per Ulqinin është 68% tabela nr: 14).

Tabela nr. 14. Lagështia relative mesatare mujore dhe vjetore në Ulqin (1949—1978)

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Mes. vjetore
%	67	68	67	70	72	69	63	63	67	68	71	69	68

Lagështinë më të madhe relative rajoni i Ulqinit e ka ne muajin maj (72%), ndersa me te vogël ne gusht (63%). Kjo njeherit është si pasoj e temperaturave te larta gjate verës. Nga muajt e veres (korrik, gusht) lagështia relative e ajrit vjenë duke u rritur gradualisht kah muajt e vjeshtes dhe te dimrit, ndersa me e madhe është ne pranverë si rezultat i temperaturave te ulta dhe te faktoreve te tjerë. Rajoni i Ulqinit i perket tipit maritim te lagështisë se ajrit. Lagështia e madhe relative e ajrit ne muajt e verës zbut deridiku thatesinë e cila gjatë korrikut dhe gushtit është e pranishme në këtë rajon.

Nga sa u tha më lartë del se ky rajon ka raport te drejtë ne mes te lageshtisë dhe te temperaturave të ajrit ku jeta e njerzëve ne këtë rajon është shumë e pershtateshme dhe e këndëshme ne çdo aspekt.

SHTYPJA E AJRIT DHE ERËRAT

Karakteristikat themelore te shtypjes se ajrit dhe te erërave ne Ulqin janë per periudhen 1958—1976 per shtypje te ajrit, ndersa nga viti 1949—1978 per erërat. Këto elemente klimatike janë në mvarshmeri reciproke sepse fusha e presionit te ajrit percakton edhe rrymat ajrore.

Levizja ditore dhe mujore e shtypjes se ajrit është ne mvarshmeri prej ndryshimit te temperatures, rrymave te ajrit dhe stineve te vitit. Gjate tërë vitit ne Ulqin shtypja e ajrit pothuaj është stabile dhe nuk ka ndryshime te medha. (tabela nr: 15). Minimumi paraqitet ne korrik si rezultat i nxemjes

[17] Dr Tomislav Šegota, *v. c.* f. 457.
[18] Dr Marko Milosavleviq, *v. c.* f. 115.

se bazes, ndersa maksimumi ne janar. Shtypja mestare e ajrit ne Ulqin eshte 752,9 mm Hg.

Tabela nr. 15. Shtypja mujore dhe vjetore e ajrit në Ulqin (1958–1976)

Muajt	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	vjetore
mmHg	755,4	753,1	751,9	751,1	752,3	752,4	751,7	752,1	753,2	754,4	754,2	753,0	752,9

ERËRAT

Era si element klimatik është funksion i qarkulimit te atmosferes dhe formes së topografisë se terrenit. Nga ndryshimi i vetive termike te erërave, te cilat periodikisht paraqiten ne rajonin e Ulqinit, paraqesin element me rëndësi klimatike dhe japin kontribut per formimin e karakterit te klimes se rajonit te Ulqinit. Si pasojë e kushteve topografike te terrenit në rajonin e Ulqinit dominojnë erërat veri-lindore (45%), ndersa me pak ato lindore (14%), perendimore (13%), ndersa ditë te qeta ka pak (11%). Ne lidhje me to shih tabelen nr: 16.

Tabela nr. 16. Trandofilja e ererave ne Ulqin (1949–1978)

Drejtimi	N	NE	E	SE	S	SW	W	NW	C
Pjesmarrja %	1	45	14	3	5	2	13	6	11
Forca mesat. në bofora	1,8	2,0	1,8	1,8	4,0	2,0	2,0	2,0	–

Erërat me te rëndësishme ne këtë rajon janë murlani (nga VL), shiroku (nga ana jugore) dhe maestrali (P). Secila nga keto erëra është bartese e tipit te caktuar te motit.

Murlani – është erë shumë e rëndësishme në tërë bregdetin ku është e pranishme gjate stines se dimrit, kur është shtypja e lartë ne Evropen e Mesme ndersa e ulet ne Mesdhe apo ne Adriatik. Ne pergjithesi murlani është erë e ftohet qe fryen nga kuadranti veri-lindor. Pasi është erë e ftohet ndikon ne zvoglimin e lageshtisë relative te ajrit. Ajo e zbret temperaturen dhe e ftohen motin por ne aspektin psiqik ndikon mirë te njeriu. Kjo me se miri verehet kur murlani fryen pas një kohe te gjatë te shirokut. Ateher ai perveç freskimit te motit nderpret reshjet dhe shton numrin e diteve te kthiellta.

Shiroku-ka veçori te kundërta me murlanin. Bën pjesë ne grupin e erërave nga kuadranti jugor dhe juglindor. Është erë e nxehtë dhe me lagështi Fryen perkohsisht gjatë tërë vitit e veçanerisht nga tetori e deri ne mars. Ne këtë pjesë te bregdetit arrin shpejtesinë më të madhe sepse ky është i çelur andaj nuk ka kurrfarë pengesash, ku ajo ne disa raste e kalon shpejte-

sinë mbi 80 km/orë.[19] Fryen mesatarisht katër ditë, ndersa me nderprerje mund te zgjase deri ne 14 ditë. Kjo ere sjell shi dhe eshte shumë e fortë. Ne Ulqin merr pjese shume pak (5%). Ne rajonin e Ulqinit ndikimi i shirokut ndikon negativisht ne lundrim sepse valet qe kriohen me kete rast pengojnelundrimin ne det, Bunë dhe ne liqenin e Shasit. Pasi kjo erë sjell reshje dhe është e butë ka ndikim pozitiv ne organizmin e njeriut.

Maestrali-ne rajonin e Ulqinit vjen nga kuadranti perendimor dhe ai jug--perendimor. Kjo është erë e nxehtë. Veçori kryesore e saj është shpejtesia konstante e saj qe fryen ne nje drejtim prandaj është shume e pershtatshme per lundrim (velanije). Ne pergjithesi është erë e dobët, ndersa rrallë herë arrin shpejtesinë 3—5 bofora. Maestrali është si pasojë e ndryshimeve te ajrit ne mes perendimit (maksimumit te anticikloneve ne zonen e azoreve) dhe te lindjes (fusha e ulet e shtypjes se ajrit); ku deri sa zgjasin keto ndryshime ne ajer do te jetë edhe ky rrymim.

Ne bregdetin e Ulqinit maestrali fillon te fryej paradreke rreth ores 10 dhe zgjat deri ne mbrëmje deri ka ora 19. Është erë shumë e këndëshme, sjellë freski, ku gjatë muajve të veres ka veti shumë te mira bioklimatike. Intenzitetin më të lartë e ka deri ne lom/sec nga ora 14—15. Ne mbremje (ka ora 19) kjo nderpritet dhe fillon te fryeje era lindore (nga toka) me ndryshim nga maestrali qe vjen nga deti. Pasi Ulqini ka 107 ditë te nxehta do te thot se vera është stinë e gjatë dhe e thatë ku ne këtë rast maestrali luan nje rol te rendesishem ne freskimin e saj gjë që e bën më të pershtatshme ne aspektin e aktiviteteve turistike. Maestrali merr pjese me 13% qe per nga sasia është ne kategorinë e tretë te erërave në këtë rajon. Në këtë tip të eres duhet llogaritur edhe eren JP (2%) dhe ate VP(6%). Sa i perket shpejtesisë se eres deri në 6 bofora me teper ditë të tilla ka ne dhjetor (5,2), nëntor (4,8) dhe shkurt (4,7) ndersa me pak ne korrik dhe gusht (2,1 ditë). Me shpejtesinë me 6 bofora ne vite janë gjithsej 40,2 ditë. Nga ana tjeter numri i diteve me shpejtesi te eres prej 8 boforash ne vite është shumë i vogël (8,7). Me teper ka në dhjetor (1,7 ditë), nëntor (1,2), tetor (1,1) ndersa me pak ne janar, shkurt e mars (0,9 ditë) etj.[20]

Perveç erërave te cekura te cilat janë dominuese në këtë rajon poashtu janë të pranishme edhe erërat lokale. Keshtu ata gjatë dites fryejnë ne drejtimin det-tokë, ndersa naten anasjelltas. Edhepse janë erëra me intenzitet te vogël dhe kanë karakter lokal ndikojnë ne regjimin termik te motit ne këtë rajon.

PËRFUNDIM

Punimi paraqet nje ndër tentimet e para te kërkimeve komplekse klimatike per rajonin e Ulqinit. Analiza e elementeve klimatike, në punim paraqet lidhshmerinë ne mes tyre si dhe ndikimin e tyre ne elementet tjera

[19] Grup autoresh, *Potencijali* ... f. 19.

[20] Studija prirodno geografske karakteristike opštine Ulcinj, ZUKD, Beograd, 1983, f. 20. Poashtu të dhënat statistikore për këtë punim janë marrë nga ky publikim, ndersa tabelat janë punuar nga autori.

te bazes natyrore dhe ne jeten ekonomike e shoqërore. Duke u bazuar ne faktoret klimatikë dhe ne veçoritë morfologjike te relefit ne këtë rajon kemi tipin e klimes mesdhetare dhe nen tipin e saj ate te ndryshueshme mesdhetare. Ne pjesen e brendeshme te ketij rajoni (ne thellësi te zones malore) paraqitet edhe varianti i klimes malore.

Rajoni i Ulqinit bën pjesë ne rajonin klimatik mesdhetar qe është nen ndikimin e drejteperdrejtë te Detit Adriatik. Vererat janë të nxehta dhe te thata ndersa dimrat te butë dhe me reshje. Periudha vegjetative ka me pak reshje se sa ajo jashtë sajë. Andaj gjatë veres praqiten edhe thatësirat që negativisht ndikojnë ne bimësi.

Klima e rajonit te Ulqinit sipas klasifikimit të Kepenit të klimateve ne Jugosllavi, ne pergjithesi bën pjesë ne varianten Csa. Duke analizuar elementet klimatike dhe proceset natyrore ne raport me veprimtarit njërëzore, është si kerkesë e kohes që të behen analiza ne këtë aspekt. Më një fjalë per caktimi i mvarshmerisë dhe i diferencimit klimatik është i rëndësishem sidomos per ato aktivitete ku elementet klimatike kane ndikim parësor, andaj në këtë aspekt mbetet shumë për t'u punuar.

LITERATURA

1. Vasović, dr Milorad: *Geografske odlike Crne Gore*, Crna Gora (monografija), Književne novine, Beograd, 1976.
2. Vasović, dr Milorad i dr Jovan Petrović, *Regionalna podjela Crne Gore*, Crn-Gora (monografija), Književne novine, Beograd, 1976.
3. Šegota, Tomislav: *Klimatologija za geografe*, Školska Injiga, Zagreb, 1976
4. Radinović, dr Đuro: *Vremei klima Jugoslavije*, Građevinska knjiga, Beograd, 1981
5. Marković, dr Jovan: *Geografske oblasti SFRJ*, Zavod za udžbenike i nastavna sredstva Srbije, Beograd, 1972
6. Vujević, dr Pavle: *Podneblje Crne Gore*, Zbornik radova V kongresa geografa Jugoslavije, Cetinje, 1959
7. Grup autoresh: *Potencijali uspona priobalnog područja SR Crne Gore*, IDEI, Titograd, 1970
8. Milosavleviq, dr Marko: *Meteorologjia*, ETMM i KSAK, Prishtinë, 1983
9. Studija prirodno geografske karakteristike opštine Ulcinj, ZUKD, Beograd, 1983
10. Mijoviq, Pavle: *Ulqini, Ulqin* 1977
11. Enciklopedija Jugoslavije 2, Zagreb, 1982
12. Draga, Nail: *Lumi Buna-veçorite hidrografike*, Kërkime gjeografike, SHGJK, nr: 6, Prishtinë, 1985

KLIMA ULCINJA

Nail Draga

Rezime

Rad predstavlja jedan od prvih pokušaja kompleksnog proučavanja klimatskih osobenosti Ulcinjskog kraja. Analiza klimatskih elemenata u ovom radu, predstavlja njihovu medusobnu povezanost, kao i njihov uticaj u drugim elementima prirodne osnove i u

društveno-ekonomskom životu. Oslanjajući se na klimatske faktore i morfološke odlike reljefa ovo područje ima sredozemnu i promenljivu sredozemnu klimu.

Ulcinjski kraj pripada sredozemnoj klimatskoj regiji, koja je pod uticajem Jadranskog mora. Ulcinj ima toplo leto sa srednjom temperaturom letnjih meseca 23,5 °C i blage zime sa 8,1 °C. Ovaj kraj spada u najsunčanija mesta na Jadranu, sa 2563 sunčanih časova godišnje. Prosečan iznos osunčavanja na dan je veoma velik (7,02 časova). Padavine (1321 mm godišnje) imaju sezonski karakter tj. najviše padaju tokom vanvegetacionog perioda 907 mm ili 68,6%. Vegetacioni period ima visoku srednju temperaturu od 20,5 °C što je rezultat manje oblačnih i kišovitih dana. Sneg retko pada u zimsko doba godine, a i kada pada malo se zadržava.

Klima Ulcinjskog kraja prema Kepenovoj klasifikaciji klimata Jugoslavije pripada varianti Csa. Uspostavljanje veze između klimatskih elemenata i prirodnih procesa, u što većem broju ljudskih delatnosti, nameće se kao prirodni nastavak i krajnji cilj analize i objašnjavanja klime. Precizno određivanje zavisnosti naročito je važno u onim aktivnostima, u kojima klimatski činioci imaju odlučujući uticaj.

THE CLIMATE OF ULQIN

Nail Draga

Summary

